



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë

PROCESVERBAL

Tiranë, më 25.02.2019, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Klodiana Spahiu – nënkryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Seancë dëgjimore me grupet e interesit për projektligjin "Për nxitjen e punësimit".

(Komisioni përgjegjës)

Marrin pjesë:

Klodiana Spahiu, Arben Kamami, Ilir Pendavinji Edlira Bode, Adelina Rista, Nuri Belba, Roland Xhelilaj, Almira Xhembulla, Blerina Gjylameti dhe Vilma Bello.

Mungojnë:

Petrit Vasili, Bardh Spahia, Klotilda Bushka, Grida Duma Shqina, Orjola Pampuri, Lindita Metaliaj, Halim Kosova, Floida Kërpaci dhe Vangjel Tavo.

Të ftuar

Erind Pirani - ndihmëskomisioner nga Avokati i Popullit

Migena Mollanji- përfaqësuese e Qendrës për Zhvillim Komunitar “Sot për të ardhmen”

Iris Aliaj- avokate e Qendrës “Për nisma ligjore dhe qytetare”

Ervis Çota - Drejtor Ekzekutiv i Lëvizjes Rinore Egjiptiane Rome

Abdulla Omuri - kryetar i Shoqatës së Invalidëve të Punës së Shqipërisë

Sami Kariqi - Zëvendëspresident i Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Shqipërisë

Ervis Bedo – përfaqësues i Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore

Irida Qosja –përfaqësuese e Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore

Eda Beqiri - përfaqësuese e Inspektoratit Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore

Mimoza Hasani - përfaqësuese e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave

HAPET MBELDHJA

Klodiana Spahiu – Mirëdita!

Sot në rendin e ditës kemi seancën dëgjimore me grupet e interesit për projektligjin, që e kemi diskutuar disa ditë më parë, për nxitjen e punësimit. Është në praktikën e këtij komisioni që çdo projektligj që kalon të konsultohet dhe të bëhen seanca dëgjimore me grupet e interesit.

Të ftuar nga Avokati i Popullit kemi ndihmëskomisionerin për të Drejtat e Njeriut, zotin Erind Pirani, nga Qendra për Zhvillim Komunitar “Sot për të ardhmen”, është zonja Migena Mullanji, nga Qendra për Nisma Ligjore dhe Qytetare, zonja Iris Aliaj, avokate, nga Lëvizja Rinore Egjiptiane Rome drejtori ekzekutiv, zoti Ervis Çota, nga Shoqata e Invalidëve të Punës, kryetari, zoti Abdulla Omuri, dhe nga Bashkimi i Sindikatave të Pavarura, zëvendësprezidenti, zoti Sami Kariqi, nga Sindikata e Punonjësve të Postë Telekomunikacionit, kryetari, zoti Renato Muçaj, nuk ka ardhur, si edhe përfaqësuesit e ministrive dhe inspektoratit të punës.

Faleminderit të gjithëve për prezencën! Bashkëpunimi i mirë me të gjitha grupet e interesit dhe përfaqësuesit e ministrisë do ta bëjë këtë projektligj të ketë dakordësi nga të gjitha grupet e interesit me projektin që ka sjellë qeveria.

Ne i kemi marrë opinionet tuaja, i kemi lexuar, kemi bërë bashkëbisedim me përfaqësuesit e ministrisë, që janë edhe prezent sot në komision, dhe do të përpiqemi që kërkesat e parashtruara nga ju dhe që janë të drejta të pasqyrohen edhe në ligj.

Fjalën e ka përfaqësuesi i Avokatit të Popullit.

Erind Pirani – Përshëndetje!

Duke ju falënderuar për ftesën që i keni dërguar institucionit të Avokatit të Popullit, në përmbushje të misionit tonë kushtetues për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, ne kemi përgatitur disa amendime, të cilat jua kemi sjellë, por për efekt kohe po i referoj shkurtimisht.

Paraprakisht kemi konstatuar faktin se mund të ishte i domosdoshëm një harmonizim ose unifikim i termave, të flitet për shërbime publike dhe pastaj nëpër rreshta për punëdhënësit publikë dhe privatë, sipas mendimit tonë mund të harmonizohet shtrirja e veprimit dhe qëllimit të zbatimit të ligjit.

Gjithashtu, kemi konstatuar edhe një term që mund të rishikohet ose mund të përmirësohet lidhur me punësueshmërinë e personave. Sipas mendimi tonë mund të përdoret termi “punësim” ose “aftësim për punë”. Kjo mund të rishikohet me kolegët e inspektoratit ose të ministrisë.

Gjithashtu, kemi konstatuar një regres në kuadër të përmbushjes së normave, që mund të aplikohen në të ardhmen nga zbatimi i ligjit. Bëhet fjalë konkretisht për persona me aftësi të kufizuara, norma e të cilëve parashikohet si detyrim për t’u përmbushur ose aplikuar nga punëdhënësi të ndryshëm, dhe e cila ka qenë që në çdo 25 punonjës, një duhet të ishte me aftësi të kufizuara, ndërkohë që projektligji parashikon që në çdo 50 punonjës, njëri duhet të jetë me aftësi të kufizuara. Kjo nuk duhet të ndodhë.

Gjithashtu, kemi konstatuar edhe probleme me fondin social, ku si normë aplikimi në rast të mospërmbushjes së kësaj garancie, që është parashikuar për personat me aftësi të kufizuara, derdhet një kontribut prej 50% të pagës minimale mujore në fondin social. Ne mendojmë që për të rritur detyrimin e punëdhënësit për ta zbatuar këtë normë të punësimit të personave me aftësi të kufizuara, norma të jetë 100% e pagës minimale mujore, me qëllim që në çdo rast fondi social të mund të garantojë ose të mund të paguajë qoftë edhe një pagë minimale për një person që duhej të ishte punësuar në një ndërmarrje ose institucion publik ose privat.

Së fundi, duke u nisur nga problematika e konstatuar rishtazi për dhunën në familje, mendojmë që të garantohet ose parashikohet një program i veçantë edhe për gratë e dhunuara.

Klodiana Spahiu- Faleminderit!

Propozimet tuaja i kemi edhe me shkrim dhe ju garantojmë që do të diskutohen edhe me përfaqësuesit e ministrisë.

Fjalën e ka përfaqësuesja e Qendrës për Zhvillim Komunitar “Sot për të ardhmen”, zonja Migena Mullanji .

Migena Mullanji – Faleminderit!

Duke qenë se veprimtaria e qendrës sonë lidhet me subjektin e kërkuar për opinion, që nga viti 2014 ne punojmë në strukturat rajonale lokale të punësimit dhe formimit profesional në: Shkodër Pukë dhe Lezhë, në kuadër të një programi zhvillimor SID, por tani edhe në qytetet e Durrësit, Tiranës.

Kemi ofruar asistencë teknike, mbështetje në realizimin e aktiviteteve dhe më tej kemi mbështetur punën e këtyre strukturave në terren, përmes ndërhyrjeve të drejtpërdrejta me përfitues në këshillim, ndërmjetësim për punësim, programe ekstra kurrikulare.

Çfarë kemi menduar ne se duhet të ndryshojë?

Së pari, përcaktimin dhe shtimin në një nen të veçantë në projektligj të kompetencave të institucionit përgjegjës për punësimin dhe aftësinë.

Në një nga sfidat në këtë sektor është fleksibiliteti i institucional për t'iu përgjigjur nevojave të tregut rajonal dhe lokal të punës. Në këtë kuadër projektligji nuk ka të parashikuar në kreun 2, në vijim të nenit 5, kompetencat e ministrisë në lidhje me politikat e punësimit, kompetencat e institucionit përgjegjës për zbatimin e politikave publike në ministritë përkatëse, përmendur në pikën 3 të nenit, si edhe në nenin 25 “Dispozitat kalimtare”.

Në “Dispozitat kalimtare” pika 1 përcaktohet se deri në momentin e krijimit të këtij institucioni funksionet e saj do të kryhen nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit, ndërkohë që projektligji nuk ka të parashikuar cilat janë këto kompetenca.

Gjithashtu, në kreun 5 të projektligjit “Institucioni përgjegjës për punësim dhe aftësim” ka të përcaktuar dhe të parashikuar funksionimin e këshillit të këtij institucioni përkatësisht këshillin konsultativ tripalësh dhe këshillin vendor tripalësh. Sipas mendimit tonë, kompetencat e këtyre duhet të reflektojnë kompetencat institucionale përgjegjëse, pra duhet të jepet kuadri i kompetencave të institucionit.

Duke parë disa prej të drejtave të këtij institucioni në kreun 6 neni 17, më së shumti, si përpunim i informacionit, mbetet e paqartë tipologjia e institucionit në funksionim të ushtrimit dhe zbatimit të këtyre politikave, rishikimi i përbërjes dhe shtrirjes së kompetencave të këshillit vendor tripalësh.

Në nenin 16 të kreut 5, “Institucioni përgjegjës për punësim dhe aftësim”, përbërja e këshillit vendor tripalësh nuk reflekton qëllimin për të cilin ngrihet ky këshill. Çfarë është për ne e rëndësishme? Sipas pikës 1, këshilli ngrihet si organ konsultativ pranë strukturës rajonale vendore prej 7 anëtarësh, ku 4 anëtarë ka vetë institucioni dhe institucionet shoqërore të papërcaktuara, të cilat janë të propozuara nga vetë këta anëtarë. Më tej në këtë përbërje nuk ka asnjë përfaqësues nga shoqëria civile, e cila është promotor i ndërlidhjes mes grupeve të veçanta dhe institucioneve publike, si dhe ofruesi kryesor në shumë vende i këtyre shërbimeve komplementare të institucioneve.

Në pikën 2, qëllimi i këtij këshilli për të propozuar ide për përmirësimin e shërbimeve të punësimit, dobishmëria sociale ekonomike nuk mund të bëhet vetëm nga institucionet pa pjesëmarrjen e shoqërisë civile.

Së treti, përmirësimi i shërbimeve të zbatimit të programeve aktive të tregut të punës nga zyrat rajonale vendore

Së katërti, detajimi dhe përmirësimi i masave të programeve pasive të tregut të punës.

Kreu për programet pasive të tregut të punës nuk është i plotë në nenin 18. Në këtë kapitull duhet të trajtohen edhe masat, të cilat duhet të reflektojnë sfidat që hasen aktualisht, sepse janë të evidentuara në programet pasive të tregut. Një ndër sfidat është dhe zbatimi i VKM-së nr.162, datë 21.03.2018. Edhe ne, si organizatë, por edhe në takimin që kemi pasur me partnerë të tjerë kemi vlerësuar që VKM-ja nr. 162, ka sjellë shumë problematika për përfituesit nga zyrat përkatëse të punës.

Në pikën 1 të kësaj VKM-je parashikohet që punëkërkuesit e papunë, të cilët kanë pranuar të marrin pjesë në një kurs të formimit profesional mund të përfitojnë një pagesë pjesëmarrjeje në kurs në masën 50% të të ardhurave nga papunësia me kusht që ata të mos përfitojnë gjatë kësaj periudhe ndihmën ekonomike ose pagesën e papunësisë, duke shtuar kështu që kjo pagesë e përfutur me anë të VKM –së është vetëm 3 muajore dhe këta njerëz shpërkëputen kështu nga skema dhe nga mbështetja që marrin gjatë kësaj kohe.

Së pesti, në nenin 22, përdorimi i fondit social të punësimit në kreun 7 mbetet i paqartë përdorimi i fondit, ndarja e tij dhe përcaktimi i një tavani për programet e ndryshme ose edhe për ndarjen territoriale. Gjithashtu, mbetet e paqartë se si përcaktohet madhësia e këtij fondi, si sigurohet, në çfarë forme sigurohet shpërndarja e tij dhe nga kush zbatohet. Nevojitet të shtohet edhe një rishikim për transparencën e përdorimit të këtij fondi.

Faleminderit!

Klodiana Spahiu – Faleminderit!

Ju edhe në Durrës keni një kontribut në një zonë që është e vështirë, kështu që shpresoj në bashkëpunimin tuaj pas miratimit të këtij projektligji.

Vazhdojmë me zonjën Iris Aliaj, përfaqësuese e Qendrës për Nisma Ligjore dhe Qytetare

Ju lutem, fokusohuni vetëm në propozimet konkrete, sepse ne materialet i kemi marrë të gjitha.

Faleminderit!

Iris Aliaj – Faleminderit, zonja kryetare!

Të nderuar deputetë, anëtarë të shoqërisë civile dhe të institucioneve shtetërore,

Në radhë të parë doja t'ju falënderoja për të gjithë procesin, mënyrën se si e keni organizuar, duke bërë të mundur që edhe ne si pjesë e shoqërisë civile të jemi të pranishëm në këtë

seancë dëgjimore dhe të kemi mundësi të japim propozimet tona konkrete në lidhje me projektligjin.

Qendra në të cilën jam pjesë ka dhënë një propozim konkret që lidhet me riformulimin e nenit 3, pika 17 germa “h”, prandaj ne sugjerojmë se është e nevojshme të specifikohet më mirë se cilat janë viktimat e dhunës me bazë gjinore. Viktimat e dhunës në familje, si dhe ato të dhunës seksuale aktualisht nga legjislacioni gëzojnë mbrojtje si nga Kodi i Procedurës Penale po ashtu edhe nga ligje të posaçme si ligji “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” apo garancitë që ofron ligji “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, por ndërkohë edhe viktimat të tjera të dhunës me bazë gjinore mund të promovohen si rezultat i zbatimit të këtij ligji. Rekomandimi konkret që ne kemi dhënë në lidhje me nenin që ju përmenda është që të specifikohen viktimat në këtë mënyrë: viktimat të trafikimit të qenieve njerëzore, viktimat të dhunës në familje, viktimat të dhunës seksuale dhe viktimat të tjera të dhunës me bazë gjinore.

Faleminderit!

Klodiana Spahiu – Shumë faleminderit edhe për menaxhimin e kohës!

Në fakt, propozimi juaj është shumë i drejtë dhe ne e kemi diskutuar me kolegët, prandaj shpresoj që ky ndryshim do të reflektohet.

Në radhë është Lëvizja Rinore Egjiptiane Rome, me përfaqësues Ervis Çota, drejtor ekzekutiv.

Ervis Çota – Përshëndetje!

Unë shkurtimisht do të fokusohem te disa prej çështjeve që ne i konsiderojmë si më kryesoret, pasi të gjitha komentet tona i kemi referuar me shkrim.

Konkretisht, në nenin 3, pika 17, që u përket grupeve të veçanta të disavantazhura në tregun e punës, sugjerojmë që si pikë e veçantë të përfshihen edhe kërkuesit prindër që kanë një fëmijë me aftësi të kufizuara.

Sa i përket nenit 11, pika 1, programi dhe nxitja e punësimit dhe politikave nxitëse të punësimit që mbështesin punëdhënësit për krijimin e vendeve të reja të punës, sugjerojmë që firmat, të cilat përfitojnë buxhet nga shteti për investime publike, një përqindje e caktuar punëkërkuesish të merren pikërisht të papunët që janë regjistruar në zyrat përkatëse të punësimit.

Sa i përket nenit 11, pika 2, i cili flet për kostot që subvencionohen për punëkërkuesit që angazhohen në programet e nxitjes së punësimit, sugjerojmë të shtohet si pikë e veçantë edhe subvencionimi i kostove për shërbimet mbështetëse, si për shembull, mbështetja e prindërve që

kanë shumë fëmijë për pagesën e çerdheve dhe të kopshteve, e cila do ta lehtësonte së tepërmi angazhimin e këtyre personave në programet e nxitjes së punësimit.

Sa i përket nenit 16, pika 4, i cili flet për këshillin vendor tripalësh dhe përbërjen e tij, aty është parashikuar që 2 prej anëtarëve të këshillit të jenë nga organizatat më të përfaqësuara të punëmarrësve. Faktikisht, sa i takon kësaj ne kemi një paqartësi. Cili është qëllimi me organizatat e punëmarrësve, është i sindikatave apo edhe i organizatave që mbrojnë interesat e punëmarrësve që i përkasin një kategorie apo një minoriteti të caktuar? Pra, sa i takon kësaj ne sugjerojmë të jenë edhe organizata të tilla, sepse do t'i jepte më tepër vlerë këshillit vendor tripalësh.

Gjithashtu, dua t'ju them se në ligj nuk parashikohet një mekanizëm mbrojtës për individët, të cilët janë aplikues në mënyrë sistematike pranë Zyrrave Rajonale të Punësimit dhe është provuar që për një kohë të caktuar nuk u është ofruar asnjë mundësi punësimi. Ajo që ne sugjerojmë është që të parashikohet një mekanizëm i veçantë ankimimi në rrugë administrative në rastet kur punëkërkuesit provojnë se për një kohë të caktuar nuk u është mundësuar apo ofruar asnjë mundësi punësimi nga Zyrrat Rajonale.

Këto ishin disa prej çështjeve që doja të parashtroja para jush.

Faleminderit!

Klodiana Spahiu – Faleminderit, Ervis!

Një pjesë e propozimeve tuaja janë ripropozime nga organizatat e tjera, prandaj shpresoj shumë që disa prej pikave do të miratohen patjetër.

Kalojmë te kryetari i Shoqatës së Invalidëve të Punës së Shqipërisë, zoti

Abdulla Omuri.

Abdulla Omuri – Faleminderit, zonja kryetare!

Zonja dhe zotërinj deputetë,

Sa i takon këtij projektligji, sepse duke qenë drejtues, jam edhe vetë përfitues, si invalid. Pas shumë diskutimeve, me keqardhje ju them se ligji ka kaluar në qeveri pa u konsultuar me grupet e interesit. Pra, derisa ne po jua themi gjërat hapur, edhe ju duhet të merrni masa që institucionet shtetërore të mos shkelin ligjin.

Së pari, sa i takon ligjit për statusin e invalidit. kjo gjë është shkelur hapur.

Së dyti, ne ju kemi dhënë disa nga argumentet tona, por ndërkohë po ju them disa të tjera, të cilat i mendoj si më kryesoret.

Sa i takon nenit 7, mendoj se duhet të riformulohet në përputhje me Kodin e Punës, sepse shpeshherë ne shqiptarët përballemi me situata të tilla, ku njëri ligj ta jep dhe ligji tjetër ta heq.

Madje ligji aktual bie në kundërshtim me ligjin nr. 7703, neni 80, si dhe me ligjin nr. 7889, neni 16 të tij dhe mbi të gjitha me nenin 59, germa “f” dhe nuk arrij ta kuptoj se kush kanë qenë ata juristë që janë marrë me këtë ligj.

Megjithatë, e vetmja mirësi që ka dhe që është për t’u lavdëruar është futja e fondit social.

Sa i takon nenit 27, jemi të mendimit që Këshilli Konsultativ Monitorues nuk duhet të jetë vetëm këshill konsultativ, sepse nuk ka më kuptim, fjalët e bukura kanë ikur me kohë. Dihet që para viteve ’90-të ka qenë një drejtori në Komitetin Ekzekutiv, ku nënkryetari i komitetit, për këtë arsye po e sjell në vëmendjen tuaj se ndoshta i keni harruar ato ligje, ishte këshillues, ishte edhe monitorues, sepse nuk ka ndonjë person tjetër që t’i vërë në dukje ato gjëra që nuk realizohen. Më parë ka qenë Inspektorati i Punës, siç thoshte 24-1 e të tjera, por për arsye kohe nuk po jua përmend të gjitha, pasi të gjitha këto ju i keni të shkruara.

Sa i takon nenit 20, në fund të paragrafit të parë duhet të shtohet një pikë me këtë përmbajtje: “Në raste të falimentimit (me të cilat ne po përballemi çdo ditë) të një kompanie apo të një punëdhënësi para se të jepet leja për falimentim apo të mbyllet aktiviteti duhet të shihen të gjitha listat e sigurimeve shoqërore apo shëndetësore”. Pse duhet të bëhet kjo? Kjo duhet bërë (për shembull unë jam në gjyq me 3-4 veta), sepse sot punëdhënësit, të cilët shpesh lavdërohen para komisioneve tuaja sikur kanë bërë mrekulli, sepse janë të lidhur edhe me politikën, kur vjen puna te aksidentet i lënë njerëzit në mëshirë të fatit, i dërgojnë 1 milion lekë në spital dhe ikin pa bërë as procesverbalin. Pra, kjo gjë duhet parë mirë që nesër mos t’i lënë njerëzit në mes të rrugës pa sigurime shoqërore dhe pa pension.

Jam shumë i pakënaqur me nenin 21, sa i takon koeficientit që është shtuar për këtë masë, padrejtësisht. Nuk e di se ku e kanë marrë, por dua ta sjell në vëmendjen tuaj, duke e krahasuar me Malin e Zi, se atje disa persona e kanë 900 koeficientin, po ashtu edhe në Kroaci. Duke qenë se unë jam zgjedhur dhe përfaqësor Shqipërinë në forumet ndërkombëtare të Federatës Europiane të Njerëzve të Paaftë, si dhe nënkryetar i Komisionit të Çështjeve Sociale të MITIK-ut e njoh mjaft mirë punësimin, qoftë në rajon, qoftë në Europë, dhe për këtë arsye jam duke punuar me ILO-n në Zvicër dhe në muajin prill do të jem në Gjenevë.

Pra, sa i takon ligjit që po diskutohet sot, edhe sikur ta miratosh me koeficientin 50% është një mrekulli. Ky ligj është hartuar vetëm për DN 9355, që personat me aftësi të kufizuar që janë invalidë të plotë, urojmë që ata të futen në punë, por, në fakt, nuk kanë të drejtë të futen në punë. Po 29 200 invalidët e pjesshëm që janë me të drejtë për punë kush i kthen në punë? A dini që sot, pas ligjit nr. 7995, duhej të ishin të punësuar në administratën shtetërore 4712 njerëz kur

në fakt janë 712 të punësuar, ndërsa te privati janë 317? Atëherë, për mua, në qoftë se nuk kthehet ky nen, duhet bërë një nen tjetër në parametrat që kemi për arsyen e vetme se do të bëhemi objekt bisede në rajon.

Çfarë mund të themi për nenin 59, germa “f”, shkojmë në progres apo në regres? Kush kanë qenë njerëzit që kanë punuar me këtë nen? Me keqardhje ju them se këta njerëz nuk kanë pasur nivel.

Pak a shumë këto ishin çështjet që unë kisha dhe nuk po ju bëj presion, por po nisem nga logjika. Unë personalisht jam me një këmbë, jam invalid i pjesshëm dhe KEMP-i më ka nxjerrë të aftë për një punë të lehtë 8-orëshe. Kush prej jush që ka një biznes do të më merrte në punë? Po marr si aspekt veten time, unë të paktën jam me dy fakultete dhe me gjuhë të huaja, kështu që nuk bëhet fjalë për mua, por për kolegët e mi, të cilëve u janë krijuar probleme sociale edhe në familje, janë divorcuar, por nuk është momenti t’i them këto gjëra. Unë uroj që deputetët të mos përkëdhelin punonjësit e administratës shtetërore se jeni mandatuar nga populli dhe duhet të jeni për popullin.

Faleminderit!

Klodiana Spahiu – Faleminderit, zoti Omuri!

Në fakt, të gjithë ne këtu jemi për një qëllim. Në vazhden e bisedave që ne të dy kemi bërë vazhdimisht për hir të punës dhe për hir të këtij projektligji që të dalë sa më mirë kemi arritur në disa konkluzione, të cilat mendoj se do të mbështeten edhe nga kolegët deputetë, përfshirjen e invalidëve të punës dhe të të sëmurëve, të cilët dalin nga vlerësimi i Komisionit të Aftësive për Punë si invalidë të pjesshëm apo të plotë që edhe ata të përfshihen në skemën e punësueshmërisë. Pa dyshim disa nga propozimet tuaja janë të drejta, por nuk duhet të harrojmë që për hartimin e këtij projektligji është punuar, me aq sa kam informacion, prej 4 vjetësh dhe ky është viti i pestë që ky projektligj diskutohet jo vetëm me grupet e interesit, por ka qenë edhe në interesin ndërkombëtarëve si të PNUD-it, si dhe të shumë shoqatave të tjera, të cilat na kanë mbështetur që ky projektligj të jetë sa më bashkëkohor.

Sa i takon ankesave tuaja ne do të mundohemi që, së bashku me kolegët, ato që janë më të arsyeshme t’i miratojmë. Unë mendoj se ky projektligj ka shumë anë pozitive.

E para, krijon një fond social që do të jetë i përkushtuar për personat me aftësi të kufizuara, ku pa dyshim ne do të insistojmë që të përfshihen edhe invalidët e punës. Nuk duhet të harrojmë që ne kemi miratuar një ligj të ri për aksesueshmërinë, në të cilin përfshihen më shumë grupe se sa kanë qenë për aftësinë e kufizuar, ndaj mendoj që edhe për ndryshimet që ju propozoni duhet të

shohim mirë edhe ligjin që kemi miratuar, pavarësisht se një pjesë e VKM-ve ende nuk kanë dalë, që të mos kemi mbivendosje të ligjeve.

Faleminderit, zoti Omuri, për të gjitha propozimet tuaja dhe për vëmendjen e shtuar që keni ndaj grupit që përfaqësoni!

Vazhdojmë me përfaqësuesin e Sindikatave të Pavarura të Shqipërisë, zotin Sami Kariqi.

Sami Kariqi - Mirëdita të gjithëve!

Propozimet tona i kemi çuar me shkrim dhe unë nuk dua të zgjatem. Dua t'ju vë në vëmendje gabimin e Ministrisë së Financave duke shpresuar që zyra juridike e parlamentit të mos bëjë të njëjtin gabim!

Si anëtar i Këshillit Kombëtar të Punës, dua të sqaroj edhe zotërinë që drejton organizatën e vet, se në këtë këshill nuk kanë të drejtë të marrin pjesë organizata të tjera, jo vetëm punëdhënës dhe punëmarrës, sipas konventës së ILO-s. Ju mund të merrni pjesë vetëm në Këshillin Social Ekonomik. Më falni që ndërhyra në këtë formë!

Kemi ngritur me të madhe faktin, me propozim të punëdhënësve, që sot nuk janë prezentë, nuk e di pse nuk është as Bussines Albania, as Coppy as të tjerat, kur është ulur numri nga 1 në 25 dhe është ngritur në 1 e 50 për invalidët. Ne kemi kundërshtuar, sepse juridikisht bie ndesh me të drejtën e jurisprudencës, zonja nënkryetare.

I them Avokatit të Popullit, meqë e ngriti me të madhe, që juridikisht Kodi i Punës është ligj themeltar që miratohet me 3/5-t, kurse ky është ligj i thjeshtë me 50% plus 1. Ju lutem shumë, kijeni në vëmendje, sepse nuk mund të ndryshoni dhe të godisni një ligj themeltar kur është me 3/5-t! Këtë shqetësim ia kemi ngritur edhe ministrit, i cili tha se do ta kenë në vëmendje. E para.

E dyta, përgjysmimi i pagës së invalidëve me gjysmën e pagës që sot është 13 mijë lekë, nga 26 mijë të pagës minimale, duhet të jetë të paktën 10% më shumë sesa 26 mijë lekë, sepse grupi i invalidëve po rritet duke u bërë 1 me 50.

Për sa u përket propozimeve tona, do të ngre tri pika: jemi të mendimit se duhet të kemi parasysh që të mos biem në kundërshtim me legjislacionin. Unë jam anëtar i Shërbimit të Punësimit, qoftë edhe në pjesën e Inspektoratit të Punës kemi anëtarët tanë dhe ky ligj nuk është ngritur as në Shërbimin Kombëtar të Punësimit, por ka ardhur direkt dhe na është vënë përpara pa na u njoftuar më parë me *e-mail* në Këshillin Kombëtar të Punës, ku ne kemi bërë vetëm vërejtjet momentale. Këtë vërejtje e kam bërë në momentin kur zoti Arben ishte kryetar i Këshillit Kombëtar të Punës.

Duhet të jemi të vëmendshëm, sepse nesër mund të shkojmë në gjykatë për këtë, nuk mund të dilni mbi ligjet themeltare. Kijeni parasysh, bisedoni me zyrën juridike të këtij komisioni!

Pika 2 e nenit 22 të ndryshohet dhe të bëhet si më poshtë: “Burimet e financimit të fondeve janë nga:

- Taksa 1% mbi fondin e pagave të punonjësve të ndërmarrjeve publike dhe private duhet të jetë patjetër një fond, i cili të vijë. Fondi prej 480 milionë lekësh që ka në dispozicion Shërbimi Kombëtar i Punësimit për riaftësimin në punë nuk është i mjaftueshëm, sepse edhe ai fond që është dhënë, është dhënë me kritere të caktuara dhe ne kemi thënë se, në qoftë se një vend pune sot në fasoneri mund të bëjë rreth 500-600 mijë lekë, në punët e vështira dhe profesionale siç janë: metalurgët, nëntoka, pjesa e naftëtarëve, që janë pjesa më vulnerabël dhe e rrezikshme, mund të themi, siç e ka Kodi i Punës, mendoj se një punonjës i tillë kushton jo më pak sesa 1 milion lekë.

- Transferimi nga tatim-fitimi i ndërmarrjes të destinohen për këtë fond, sepse na ndodh që jepet një fond dhe ndryshon destinacioni. Kjo po ndodh në të gjitha sferat, qoftë në Shërbimin Kombëtar të Punësimit, qoftë në inspektorate të ndryshme, qoftë edhe në bashkitë, që marrin fonde për riaftësim.

- Nga financimet e buxhetit të shtetit duhet të kemi parasysh që nuk po konsumohen të gjitha paratë për arsye se po ndahen edhe për ato qytete që nuk kanë resurse për t’i shfrytëzuar dhe i kthehen buxhetit të shtetit përsëri. Na ka ndodhur me Gjirokastrën, Sarandën, edhe Korçën i ka kthyer mbrapsht fondet e riaftësimit në punë ose të kualifikimit. Vetëm në qytetet e mëdha si Tirana, Durrësi, Vlora, të cilat kanë kapacitete nuk ndodh kjo gjë.

- Të ardhurat e tjera nga burimet e ligjshme për të përfshirë financimet dhe grantet e përfituar nga marrëveshjet ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe donatorëve të ndryshëm, të jenë më të zbatueshme për këtë destinacion, sepse na vijnë fonde të caktuara, kemi marrë edhe fonde nga sindikatat dhe, kur ka ardhur puna për t’i investuar, janë tatuar që investohen për kualifikimin e punonjësve të degëve të ndryshme. Kemi marrë para nga punëdhënësit për kualifikimin brenda asaj ndërmarrjeje dhe vjen fundi edhe këto tatohen. Duhet të përjashtohet patjetër nga tatimi riaftësimi në punë, sepse po paguan për riaftësim, kualifikim e për të tjera me radhë.

- Për sa u përket shoqatave të biznesit, ka qenë propozim i tyre që të bëhet 1 me 50, i cili bie në kundërshtim me ligjin themeltar.

- Për sa i përket 50% të pagës minimale, ajo të jetë 10% më shumë se paga minimale”, për arsye se këto janë shtresa vulnerabël.

Faleminderit!

Klodiana Spahiu – Faleminderit, zoti Kariqi, për propozimet tuaja!

Ne kemi marrë propozime edhe nga shoqata të tjera “Të ndryshëm dhe të barabartë” dhe plot shoqata që i kanë sjellë propozimet me shkrim, pavarësisht se nuk janë prezentë, të cilat do të mundohemi që t’i diskutojmë edhe me përfaqësuesit e ministrisë.

Në lidhje me diskutimin e projektligjit, jo për t’ju bërë oponencë, por të paktën nga informacioni që na kanë sjellë, shkruhet se ky projektligj është përgatitur që në vitin 2014 dhe është diskutuar në data të caktuara, në mbledhje të caktuara me përfaqësues të shoqërisë civile dhe të sindikatave.

Unë nuk i hyj dot këtij debati, pasi nuk jam përfaqësuese e ministrisë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju sikur e thatë ndryshe, që nuk është diskutuar fare me ju!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord, por në vazhdimësi mendoj se është diskutuar me ju...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Atëherë, jo se nuk është marrë mendimi juaj! Ju mendoni se nuk do të reflektohet këtu? Ne nuk kemi arritur ende në miratimin nen për nen. Shpresoj që të kemi mirëkuptimin e të gjithë propozuesve, edhe atyre të biznesit për këto ndryshime. Ftesa për në seancën dëgjimore ishte e hapur edhe për biznesin, por sot nuk kemi përfaqësues, mesa shoh. Kërkesa që ju bëni për të riçuar ku ka qenë numri 1 në 50, në fakt, është diskutuar shumë gjatë, edhe ne do të përpiqemi të bëjmë punën tonë, të gjejmë një të mesme, sepse edhe 1 në 50, ka qenë 1 në 25 në Kodin e Punës, apo jo, ka qenë...

Abdulla Omuri – Ka qenë 1 në 24 punonjës, 1 duhet të jetë invalid pune, për çdo 25 vetë, të jetë i punësuar një person me aftësi të kufizuar. Ky ka qenë ligji bazë i hartuar nga profesor Tomas, i Bankës Botërore, atëherë.

Klodiana Spahiu – Ju kuptoj, zoti Omuri, por ky ligj asnjëherë nuk ka gjetur zbatim. Në qoftë se do të kërkojmë që ky ligj të zbatohet dhe të menaxhohet ky fond social që mblidhet për politika më të mira punësimi për personat me aftësi të kufizuar, por duke futur brenda edhe invalidët e punës, mendoj se 1 në 25 është pak e vështirë, sepse edhe tregu i punës ka ndryshuar. Megjithatë, ju jeni në të drejtën tuaj. Ne do të përpiqemi të gjejmë një konsensus edhe me përfaqësuesit e biznesit, edhe me Ministrinë e Financave, që ky numër të jetë në favorin tuaj. E kuptoj shumë mirë, bashkë kemi diskutuar edhe statistikat e vendeve të rajonit se si janë, sa është

numri që përfaqësojnë dhe sa duhet të punësohen nga personat me aftësi të kufizuar, por nuk duhet të harrojmë që, nëse ne e realizojmë grumbullimin e këtij fondi social, në total pagën minimale, më duket pak e pamundur, sepse nuk e di sa do të përkrahet nga përfaqësuesit punëdhënës, por edhe 50 % e pagës minimale, nëse menaxhohet mirë, mendoj se është një e ardhur e mirë për fondin social.

Abdulla Omuri – Do të doja të shtoja edhe diçka: duke qenë se kemi qenë në Poloni së bashku me grupin e punës së Ministrisë së Financave, Ministrisë e Punës dhe Çështjeve Sociale, Ministrisë së Drejtësisë, me Avokatin e Popullit dhe Komisionerin për Diskriminimin kemi parë se si punësohen personat me aftësi të kufizuar apo invalidët e punës, dhe më vjen shumë keq nga ajo administratë të mohojë ato që kanë bërë dhe nuk hartojnë raportet, apo erdhën vetëm për të marrë dietat.

Po sjell në vëmendjen tuaj, në qoftë se ju do t'i besoni biznesit, unë po ju jap një shembull për këtë: kam ndjekur një natë në televizion një biznesmen, i cili njërit prej punonjësve që ka pësuar aksident në punë, nuk i ka bërë raportin e aksidentit.

E di që Ministria e Financave i mëshon më shumë biznesit sesa shtresave në nevojë, por, kur ta bëjë këtë, ajo duhet ta heqë Institutin e Sigurimeve Shoqërore nga vetja dhe ta kalojë te ministria tjetër, sepse e di sesa invalidë ka atje.

Faleminderit!

Klodiana Spahiu – Zoti Omuri, nuk po themi se jemi në krahun e biznesit, të lutem, që të mos keqkuptohemi! Ka qenë pikërisht insistimi juaj...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për të gjithë, se unë përfaqësoj të gjithë kolegët...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ka qenë insistimi juaj i vazhdueshëm dhe i Avokatit të Popullit që ministria ka rënë dakord për pagën e plotë minimale. Kjo është një arritje dhe bravo ju qoftë për insistimin tuaj! Unë shpresoj shumë që një pjesë të mirë të kërkesave tuaja, të arrijmë t'i reflektojmë në ligj kur të miratohet. Edhe rritja e pagës minimale e plotë në krijimin e fondit social, mendoj se është një arritje në saj të konsultimit me ju dhe me të gjitha grupet e interesit, përfaqësuar edhe nga Avokati i Popullit.

Faleminderit!

Sami Kariqi - Kemi një problem, që nuk është pasqyruar në projektligj: punët e vështira ku ndalohen me ligj të hyjnë invalidët, gratë dhe të miturit nën 18 vjeç, janë punët e nëntokës. Ligji

nuk i ka përjashtuar këto kategori, megjithëse në Këshillin Kombëtar të Punës thatë se do të përjashtohen nga punonjësit e nëntokës, sepse nuk mund të hyjnë, s'ta lejon ligji. Është një legjislacion i tërë, sepse në rregulloren e nëntokës, pasi unë vij prej andej, pavarësisht se është miratuar në parlament në vitin 1976, nuk ka ndryshuar asgjë në sigurimin teknik të nëntokës.

Ju lutem shumë, duhet të përjashtohen të gjitha ato kategori që nuk i lejon ligji nga 1 në 50, në qoftë se do të bëhet, apo 1 në 25.

Klodiana Spahiu – Pa dyshim, që kërkesa juaj do të pasqyrohet patjetër! Është bërë edhe një kërkesë tjetër prej njëres nga shoqatat për punësimin e personave me aftësi të kufizuar në gjendje të rëndë. Edhe unë jam kundër atij propozimi që është në projektligj, dhe ju garantoj që çdo propozim, edhe propozimet e atyre që sot nuk janë prezentë në seancën dëgjimore, do të diskutohen dhe shpresoj që do të bëhet më e mira.

Faleminderit edhe një herë!

Faleminderit për prezencën tuaj në komision!

MBYLLET MBLEDHJA